

**PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË
STATISTIKAVE, PËRFAQËSUES TË BOTËS AKADEMIKE**

Në mbështetje të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, dhe të pikës 2, të vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e për zgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, shpallim njoftimin për kandidim për anëtar të Këshillit të Statistikave.

Konkurrimi është i hapur për përfaqësuesin që i përket **botës akademike**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar të Këshillit të Statistikave, përfaqësues të botës akademike, janë si më poshtë vijon:

Kandidati për anëtar, përfaqësues i botës akademike, duhet që:

i. të jetë nga radhët e personelit akademik, i punësuar me kohë të plotë, në institucione të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

ii. të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e statistikave ose të ekonomisë apo shkencave të natyrës;

iii. të zotërojë tituj akademikë.

Kritere të përgjithshme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Shënim. Kandidatët për anëtar në Këshillin e Statistikave duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin që provon plotësimin e kriterëve, sipas këtij njoftimi.

Afati i dorëzimit të aplikimit është deri më 23.9.2024 dhe të dorëzohet në adresën e Kryeministrit. Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet *email*-it.

Adresa: Kryeministria
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000
Tiranë, Shqipëri
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Tel: 04 22 77 401